



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

Shkup, 19 korrik 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: qershor, 2024

- **Paraja e gjerë (agregati monetar^{1,2})**, në qershor të vitit 2024, shënoi rritje mujore prej 0,4%, kryesisht si rezultat i shumës së lartë të parave të gatshme në qarkullim, me kontribut pozitiv shtesë të depozitave pa afat dhe depozitave afatshkurtra. Rritja vjetore e parasë së gjerë është 5,4%, kryesisht për shkak të rritjes së depozitave pa afat, me rritje shtesë të depozitave afatgjata deri në dy vjet dhe të parave të gatshme në qarkullim.
- Në qershor, **totali i depozitave³** shënoi rritje mujore për 0,4%, që është rezultat i rritjes së depozitave të sektorit korporativ. Rritja vjetore e totalit të depozitave shënoi rritje për 8,2%, si rezultat i rritjes së depozitave të të dy sektorëve, me pjesëmarrje më të theksuar në sektorin e “amvisërisë”.

Tabela 1. Paraja e gjerë dhe totali i depozitave të sektorit joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (so %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024
Paraja e gjerë M4	595,151	591,336	605,088	607,881	8.7	9.5	8.5	7.6	4.3	-0.7	0.8	0.5
Paraja e gjerë M3	529,264	521,804	533,843	535,985	5.9	6.6	6.0	5.4	4.5	-0.9	0.7	0.4
<i>nga të cilat:</i>												
Paratë në qarkullim	50,002	49,336	50,265	51,377	5.3	8.6	7.4	7.6	7.5	1.5	-0.1	2.2
Depozitat e parave	211,402	202,074	210,544	211,126	12.4	11.4	9.7	8.8	10.0	-1.9	0.5	0.3
Depozitat afatshkurta	215,860	215,551	215,077	215,501	0.6	1.0	0.5	0.1	-0.5	-1.1	0.6	0.2
Depozitat afatshkurta deri në	51,999	54,842	57,958	57,981	4.5	10.8	13.5	12.7	2.1	1.4	3.2	0.0
Totali i depozitave	534,241	531,140	542,765	544,683	8.7	9.3	8.2	7.2	4.0	-0.9	0.8	0.4
<i>nga të cilat:</i>												
Sektor i korporativ	161,432	150,674	152,278	153,830	13.2	12.2	5.0	4.7	6.6	-2.4	2.4	1.0
Në denarë	109,266	100,009	101,918	103,684	15.8	12.5	6.1	5.6	8.5	-3.6	2.7	1.7
Në valutë të huaj	52,166	50,664	50,360	50,146	8.2	11.4	2.9	2.8	2.7	0.1	1.7	-0.4
Amvisëritë	348,745	354,741	364,565	364,432	7.9	8.7	10.2	8.9	3.5	0.1	0.0	0.0
Në denarë	173,543	177,631	185,724	184,627	11.8	13.7	15.9	13.1	6.4	0.6	-0.3	-0.6
Në valutë të huaj	175,201	177,109	178,841	179,805	4.4	4.0	4.8	4.8	0.7	-0.3	0.4	0.5

Burimi: BPRMV.

¹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si përkufizim i ri standard për paranë e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetar M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna_07_2021_al.pdf

³Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4, të cilat i takojnë sektorit korporativ, amvisërive, institucioneve tjera financiare, institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive dhe vetëqevirsjes lokale.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

- **Totali i kredive**, në qershor, janë rritur në baza mujore dhe vjetore përkatësisht me 0,8% dhe 6,4%. Ndryshimi në të dyja bazat rezulton nga rritja e kredisë për të dy sektorët, me pjesëmarrje më të theksuar të kredisë për sektorin e "amvisërisë".


Tabela 2. Totali i kredive në sektorin joqeveritar

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (bo %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024
Totali i kredive	444,721	449,251	458,708	462,435	5.1	6.1	6.8	6.4	1.3	0.3	0.9	0.8
<i>nga të cilat:</i>												
Sektori korporativ	212,768	214,268	220,352	221,765	3.3	5.4	6.4	5.8	2.2	0.0	0.8	0.6
Në denarë	131,089	134,280	140,468	144,110	7.1	11.9	14.8	16.2	2.7	1.0	2.4	2.6
Në valutë të huaj	81,679	79,988	79,884	77,656	-2.3	-3.9	-5.8	-9.3	1.4	-1.7	-1.9	-2.8
Amvisëritë	229,404	232,313	235,761	238,057	6.7	6.8	7.0	7.1	0.5	0.5	1.0	1.0
Në denarë	125,223	126,809	128,940	130,453	5.1	5.8	6.4	7.2	0.0	0.3	1.3	1.2
Në valutë të huaj	104,180	105,504	106,821	107,603	8.8	8.1	7.8	7.0	1.2	0.6	0.6	0.7


Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



1. Depozitat dhe kreditë e sektorit korporativ⁴





Burimi: BPRMV.

⁴ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ i përfshin korporatat publike dhe private jo financiare.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

- **Totali i depozitave në sektorin korporativ**, në qershor, është rritur për 1,0% krahasuar në baza mujore. Rritja, para se gjithash, është reflektim i rritjes së depozitave pa afat dhe në masë më të vogël nga depozitat afatgjata në valutë të huaj, në kushte të rënies së depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në denarë. Në nivel vjetor, depozitat e sektorit korporativ shënuan rritje prej 4,7%, për shkak të rritjes së depozitave pa afat, depozitave afatgjata në valutë të huaj, si dhe depozitave afatgjata dhe afatshkurtra në denarë, në kushtet e rënies së vërejtur të depozitave afatshkurtra në valutë të huaj.
- Në qershor, **kreditë e sektorit korporativ**⁵, shënuan rritje mujore dhe vjetore prej 0,6% dhe 5,8%, Respektivisht. Rritja në të dyja bazat është në tërësi si pasojë e rritjes së kredive në denarë, ndërsa kreditimi në valutë të huaj është ulur.



Burimi: BPRMV.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive⁶



Burimi: BPRMV.



⁵Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.

⁶Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe të ekzekutuesve të pavarur të veprimtarisë.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

- Në qershor, **totali i depozitave të amvisërive** mbeti i pandryshuar në bazë mujore. Në krahasim me qershorin e vitit të kaluar, depozitat e amvisërive shënuan rritje prej 8,9%, që është rezultat i rritjes së depozitave pa afat dhe depozitave afatgjata në denarë dhe në valutë të huaj, ndërsa depozitat afatshkurtra në valutë të huaj dhe denarë shënuan rënie.
- Te **kreditë e amvisërive**, në qershor është vërejtur rritje mujore dhe vjetore prej 1,0% dhe 7,1%, respektivisht, që më së shumti është rezultat i rritjes së kreditimit në denarë, me rritjen edhe të kredisë në valutë të huaj.



Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

Tabela 2. Kreditë e bankave dhe shtëpive të kursimeve të dhëna për personat fizikë, sipas qëllimit

	gjendja (në milionë denarë)				ndryshimet vjetore (në %)				ndryshimet mujore (në %)			
	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024	12.2023	3.2024	5.2024	6.2024
Kreditë konsumatore	119,868	119,858	121,816	122,818	6.5	5.8	6.1	5.8	1.1	0.4	0.7	0.8
Kreditë për banesa	83,891	85,555	87,130	87,920	10.5	10.4	10.8	10.2	1.4	1.0	0.9	0.9
Kreditë për automjete	399	399	426	458	11.4	13.1	21.7	25.3	2.7	1.8	5.2	7.5
Kartat e kreditit	9,835	9,459	9,358	9,332	-4.7	-6.8	-7.9	-8.0	-1.9	-0.8	-0.1	-0.3
Bilancet negative të llogarive rrjedhëse	6,000	6,820	6,474	6,846	0.6	6.1	-2.2	7.9	-13.8	2.3	7.3	5.7
Kreditë e miratuara mbi baza të tjera	1,782	1,658	1,610	1,579	-19.3	-21.2	-20.7	-18.8	-2.5	-1.7	-1.4	-2.0

Burimi: BPRMV.

- E analizuar sipas qëllimit të kredive të dhëna personave fizikë, në qershor 2024, kategoritë më të përfaqësuara – **kreditë konsumatore dhe banesore** shënuan rritje mujore prej 0,8% dhe 0,9%, përkatësisht, me rritje vjetore 5,8% dhe 10,2%, përkatësisht. Në qershor **kreditë për automjete** janë rritur për 7,5% në bazë mujore, me rritje vjetore prej 25,3%. Kreditë e miratuara për **kartelat kreditore** janë më të ulëta në baza mujore dhe vjetore për 0,3% dhe 8,0%, përkatësisht. Këtë muaj, **bilancet negative të llogarive rrjedhëse** shënuan rritje mujore dhe vjetore prej 5,7% dhe 7,9%, përkatësisht ndërsa kreditë e miratuara në **baza të tjera**, në qershor, janë më të ulëta për 2,0% në bazë mujore dhe 18,8%, në bazë vjetore.

Informacione shoqëruese

Seri kohore të të dhënave:: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore [Shqip - Statistika monetare \(nbrm.mk\)](http://nbrm.mk)

Shpjegime metodologjike:

[Metodologjia monetarna 07 2021 al.pdf \(nbrm.mk\)](http://nbrm.mk)

Informacioni për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit:

[https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna 07 2021 al.pdf](https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia%20monetarna%2007%202021%20al.pdf)



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për statistikë

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave
[Kalendar i publikimit të të dhënave.pdf \(nbrm.mk\)](#)

Lëvizjet monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 30 gusht 2024 (mesatare referuese, përfshirë korrikun e vitit 2024).

Për pyetje gazetarësh, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02/3215-235. lokali 108/110.